



Prishtinë: 30.03.2011

Kodi i ZRRE-së: V_357_2011

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_555_03_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_555_03_11**;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET pjesërisht ankesa e konsumatorit Bajram Izeti (shifra e konsumatorit DFE – 9002508), nga Ferizaj si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij rekomandimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 11.12.2008 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 01.12.2008 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 10.06.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit, dhe kanë bërë verifikimin e gjendjes teknike të pikës matëse, me ç'rast nuk kanë hasur në parregullsi.
Provë: Procesverbali i KEK-ut , nr. 000010 i datës 10.06.2008
- Me datë 12.09.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit, ku kanë konstatuar se ky konsumator furnizohet me një kabëll 5x2,5 mm² jashtë njehsorit elektrik, ku me këtë kabëll furnizohet lokali i cili ushtron veprimtari si Auto Larje.
Provë: Procesverbali i KEK-ut , nr. 168335 i datës 12.09.2008
- Me datë 03.10.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DFE08HP04081 në vlerë prej 4,813.72 €.
Provë: Fatura DFE08HP04081i datës 03.10.2008
- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK.
- Me datë 01.12.2008 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e inspektimit dhe kontrollës.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 01.12.2008



- Me datë 11.12.2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së i datës 11.12.2008
- Konsumatori ka prezantuar procesverbalin nga Kuvendi Komunal i Ferizajt me të cilin dëshmon se biznesi amë posedon certifikatën e rexhstrimit të biznesit nr. 80004877 të lëshuar nga agjencioni, ndërsa njësia e auto parkingut nuk posedon kurrfarë leje të vlefshme të punës të lëshuar nga organi kompetent. Me çka është vepruar në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për tregtinë e brendshme. Në këtë proces të njëjtit i është dhënë një afat prej 7 (shtatë) ditësh për lëshimin e parregullive të konstatuara nga inspektorët, marrja e lejes së vlefshme e punës për auto parking.
Provë: Procesverbali i Kuvendit Komunal nr. 146 B/08, i datës 23.09.2008
- Konsumatori ka prezantuar vendimin e lëshuar nga drejtoria për punë të inspektoratit, ku kërkon ndërprerjen e menjëhershme të punimeve për shkak se nuk është i pajisur me leje të ndërtimit nga ana e komunës.
Provë: Vendimi i Inspeksionit të ndërtimtarisë nr. 354/080 i datës 22.04.2008
- Konsumatori ka prezantuar Aktgjykimin e Gjykatës Komonale të Ferizajt P.nr. 208/09 të datës 04.02.2011, me të cilin aktgjykimin konsumatorin e ka shpall fajtor për veprën penale vjedhje nga neni 252 par. 1 të KPK-së dhe e ka dënuar me gjobë në shumë prej 350 € (treqind e pesëdhjetë euro), si dhe të dëmtuarën KEK-un e ka udhëzuar që dëmin e shkaktuar të realizoi në kontest civil.
Provë: Aktgjykimi i Gjykatës Komonale të Ferizajt P.nr. 208/09 të datës 04.02.2011
- Konsumatori ka prezantuar edhe Aktgjykimin e dytë të Gjykatës Komonale të Ferizajt P.nr. 699/08 të datës 04.02.2001, me të cilin Refuzohet Akuza, pasi që nga ana e KEK-ut, janë iniciuar dy kallëzime penale për të njëjtën vepër penale si dhe nga ana e Prokurorisë Publike Komonale janë ngrit dy Propozim Akuza ndaj këtij konsumatori, andaj Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit publik gjyqësor përfaqësuesi i akuzës është tërheq nga akuza pasi që i njëjti është dënuar për të njëjtën vepër penale me dënim me gjobë në shumë prej 350 €. **Provë:** Aktgjykimi i Gjykatës Komonale të Ferizajt P.nr. 699/08 të datës 04.02.2001

DMK, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Punëtorët e autorizuar për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit ku kanë konstatuar se konsumatori furnizohet me një kabull 5x2,5 m jashtë njehsorit elektrik, me këtë rast i njëjti energjinë e shpenzuar e ka shfrytëzuar në lokalin veprimtaria e cila ushtrohet si Auto Larje.
- ✓ Sipas procesverbalit të KEK-ut të datës 10.06.2008, punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë verifikuar pikën matëse të konsumatorit dhe se pas verifikimit kanë konstatuar se njehsori elektrik i konsumatorit është në rregull (procesverbali i KEK-ut, nr. 000010 i datës 10.06.2008), por që pas tre muajve punëtorët e KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe pas inspektimit kanë konstatuar se ky konsumator furnizohet me një kabëll 5x2,5 mm² jashtë njehsorit elektrik, ku me këtë kabëll furnizohet lokali i cili ushtron veprimtari si Auto Larje (Procesverbali i KEK-ut, nr. 168335 i datës 12.09.2008).
- ✓ Nëse fillimi i konsumit të paautorizuar, korruptimi ose vjedhja nuk mund të përcaktohet, do të supozohet që konsumi i paautorizuar ka zgjatur njëzetekatër (24) muaj për konsumatorët



komercial, ose ditën e inspektimit të fundit gjatë të cilit instalimi ka qenë në rregull. Sipas procesverbaleve të KEK-ut nr. nr. 000010 të datës 10.06.2008 dhe nr. 168335 të datës 12.09.2008 vërehet se në momentin e kontrollës së KEK-ut kur është konstatuar se konsumatori shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte me një kabëll duke anashkaluar njehsorin elektrik, vërehet se tre muaj më herët punëtorët e KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik është në rregull.

- ✓ Sipas analizave të bëra rrjedhjes së energjisë aktive shihet se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhat nga viti 2002 deri në vitin 2010 shihet se nuk ka ndonjë ndryshim të madh në mes këtyre periudhave kohore për vite. Konsiderojmë se është e vështirë të bëhet ndonjë llogaritje dhe të nxirret një mesatare e shpenzimit të energjisë eklektike për këtë konsumator pasi që i njëjti në bazë dëshmimeve që ne disponojmë nga KEK-u, ka bërë furnizimin e energjisë elektrike me një kabull $5 \times 2,5 \text{ mm}^2$, direkt jashtë njehsorit elektrik që nuk është regjistruar të cilën energji e ka shfrytëzuar për lokalin auto larje.
Provë: Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Sipas listave të leximit të KEK-ut, lexuesi i KEK-ut në listën e leximit të periudhës për muajin 11/2008 ka evidentuar se njehsori elektrik është në rregull dhe se vula shtetërore është në rregull.
Provë: Listat e leximit të KEK-ut
- ✓ DMK me datë 14.03.2011 dhe 17.03.2011 ka kërkuar nga KEK-u kompletimin e disa dokumenteve shtesë për lëndën e konsumatorit, ku kemi kërkuar kompletimin e listave të leximit për periudhën 08/2007 – 10/2008. KEK-u nuk ka arritur të siguroj të gjitha listat e leximit e kërkuara nga DMK.
Provë: Listat e leximit të KEK-ut
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike në sezonën dimërore me njehsorin elektrik nr. 17699018 për periudhën 10/2007 – 03/2008 është 132 kWh/muaj, për periudhën 10/2008 – 03/2009 është 521 kWh/muaj, për periudhën 10/2009 – 03/2010 është 454 kWh/muaj.
Provë: Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike në sezonën verore me njehsorin elektrik nr. 17699018 për periudhën 04/2007 – 09/2007 është 312 kWh/muaj, për periudhën 04/2008 – 09/2008 është 168 kWh/muaj, për periudhën 04/2009 – 09/2009 është 377 kWh/muaj, për periudhën 04/2010 – 09/2010 është 333 kWh/muaj.
Provë: Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ DMK, pas shqyrtimit dhe analizimit të hollësishëm të lëndës kemi vërejtur se KEK-u nuk ka vepruar konform dispozitave të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike gjegjësisht nenit 12 të kësaj procedure, ku rregullohet çështja e konsumatorëve komercial, andaj është dashur që energjia e shpenzuar nga ky konsumator të matet në bazë të sistemit të matjes me pajisje e jo në bazë të seksionit të kabullit siç ka vepruar në këtë rast KEK-u, gjë për të cilën nuk është dashtë të vepohet kështu.
- ✓ Në ankesën e konsumatorit theksohet se objektin ku ka qenë i vendosur njehsori elektrik ka qenë i objekt i vjetër dhe këtë e kam rrënuar dhe e kam ndërtua objekt te ri. Pas përfundimit të objektit njehsorin elektrik e kemi zhvendos nga objekti i vjetër dhe e kam vendos në



objektin e ri me datë 10.06.2008, ku edhe e kemi njoftua KEK-un, për këtë veprim, KEK-u e ka verifikua instalimin dhe e kanë bllobuar njehsorin elektrik dhe për të gjitha këto punë është përkujdesur dhe i ka përfundua punëkryesi në bazë të marrëveshjes që kemi pas me ta. Pas lëshimit të energjisë elektrike është paraqitur një defekt ku sipas punëkryesit është thënë se duhet ta ndërrojmë kabullin nga shtylla deri të njehsori nga se shtylla e drurit është shumë e dobët dhe gjatë lëvizjes po shkakton probleme dhe unë sipas rekomandimeve të punëkryesit e kam blë kabullin nëntokësor dhe e kemi vendosur, mirëpo edhe pas vendosjes së kabullit prapë kemi pas defekt dhe për këtë arsye punëkryesi nuk e ka larguar kabullin deri sa të eliminoj defektin, dhe ndërkohë ka arritur kontrollin e KEK-ut, nga Prishtina me datë 12.09.2008 dhe ka vërejtur kabullin jashtë njehsorit e cila nuk është larguar por e njëjta nuk ka pas rrym dhe ka qenë pa siguresa dhe po të njëjtën ditë nuk ka punuar një fazë dhe punëtori ka bërë disa veprime dhe ka provuar disa linja se cila ka rrym dhe atë ditë fare nuk ka punuar pompa për larjen e veturave dhe krejt në fund deklaroj se asnjë moment nuk e kam keqpërdorur energjinë elektrike, mirëpo kjo ka qenë vetëm e rastit dhe nga moskujdesi, andaj shuma që më është ngarkuar ndikon shumë në biznesin tim dhe është vështirë që mund të përballoj këtë shumë.

Provë: Ankesa e konsumatorit e datës 11.12.2008

DMK, duke u bazuar në analizat e bëra dhe argumentet e paraqitura, ka rekomanduar Bordin e ZRRE-së që të **refuzojë pjesërisht** ankesën e konsumatorit dhe vjen në përfundim se:

1. KEK-u duhet ta shkarkojë shifrën DFE - 9002508 nga fatura e rikthimit të humbjeve DFE08HP04081 në vlerë prej 4,813.72 €, të datës 03.10.2008.
2. KEK-u obligohet të respektojë nenin 12 të procedurës së përkohshme të identifikimit dhe parandalimit të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, pra KEK-u obligohet të inspektojë pikën matëse të konsumatorit, për ta bërë regjistrimin e të gjitha pajisjeve që posedon konsumatori në objekt dhe sipas pajisjeve të bëhet llogaritja e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.
3. KEK-u duhet të ngarkoj konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthim i humbjeve) vetëm për tre muaj, pra prej periudhës së procesverbalit të KEK-ut, nr. 000010 i datës 10.06.2008 e deri të procesverbalit të konstatimit se konsumatori ka qenë i lidhur direkt duke anashkaluar njehsorin elektrik.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që të **refuzojë pjesërisht** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. KEK-u duhet ta shkarkojë shifrën DFE - 9002508 nga fatura e rikthimit të humbjeve DFE08HP04081 në vlerë prej 4,813.72 €, të datës 03.10.2008.
2. KEK-u obligohet të respektojë nenin 12 të procedurës së përkohshme të identifikimit dhe parandalimit të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, pra KEK-u obligohet të inspektojë pikën matëse të konsumatorit, për ta bërë regjistrimin e të gjitha pajisjeve që posedon konsumatori në objekt dhe sipas pajisjeve të bëhet llogaritja e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.
3. KEK-u duhet të ngarkoj konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthim i humbjeve) vetëm për tre muaj, pra prej periudhës së



procesverbalit të KEK-ut , nr. 000010 i datës 10.06.2008 e deri te procesverbali i konstatimit se konsumatori ka qenë i lidhur direkt duke anashkaluar njehsorin elektrik.

4. KEK-u pasi të bënë rillogaritjen e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar (rikthim i humbjeve) sipas pikave të cekura më lartë, duhet të njoftojë ZRRE-në rreth kësaj fature të rikalkuar.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar